



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr. 78 / Prot.

27

Datë 26.10.2022

VENDIM

Nr. 918, Datë 26.10.2022

“Mbi gjatitjen e ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD për mos - zbatim të Vendimeve të Komisionit të Konkurrencës nr. 702, datë 30.07.2020 dhe nr. 793, datë 22.04.2021”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.10.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Zbatimi i VKK nr. 702, datë 30.07.2020, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe dhënieve të disa detyrimeve dhe rekomandimeve për ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD, Albpetrol dhe AKBN”, dhe VKK nr. 793, datë 22.04.2021 “Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 702, datë 30.07.2020, nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD”, nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD.

Baza Ligjore: Neni 8, neni 24, gërma (d), neni 26, neni 45, neni 74, pika 1, gërma (c), të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi zbatimin e Vendimeve të Komisionit të Konkurrencës nr. 702, datë 30.07.2020 dhe nr. 793, datë 22.04.2021 nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD; dhe

- Shpjegimeve dhe argumenteve të paraqitura nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania Ltd në seancën degjimore të realizuar më 21.10.2022, si dhe të paraqitura me shkrim, në vijim të seancës dëgjimore nëpërmjet shkresës së saj nr. 882 prot, datë 20.10.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 78/24 Prot., datë 21.10.2022).

VËREN SE :

1. Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 702, datë 30.07.2020, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe dhënien e disa detyrimeve dhe rekomandimeve për ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD, Albpetrol dhe AKBN”, pikat II, III, IV, e në vijim të dispozitivit, ka vendosur:
 - II. *Dhënien e rekomandimeve për ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD si subjekt me pozitë dominuese në tregun e prodhimit të naftës bruto në RSH:*
 1. *Të aplikojë kushte tregtimi të barabarta për veprime tregtare të njëjta ndaj ndërmarrjeve me të cilat hyn në marrëdhënie kontraktore;*
 2. *Të furnizojë ndërmarrjet e përpunimit të naftës bruto në tregun vendas, në respektim të marrëdhënieve kontraktore bazuar në dispozitat e Kodit Civil.*
 - III. *Detyrimin e Bankers Petroleum Albania LTD të depozitujë pranë AK:*
 1. *çdo raportim tremujor mbi kostot e naftës;*
 2. *çdo raportim tremujor mbi prodhimin e naftës dhe operacionet hidrokarbure.*
 - IV. *Detyrimin e Bankers Petroleum Albania LTD të depozitujë pranë AK për vlerësim paraprak çdo draft kontratë që do të lidhë me çdo rafineri, në respektim të detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.*
 - V. *T’i rekomandojë Albpetrol SHA, në respektim të Marrëveshjes Hidrokarbure:*
 - i. *Të bëjë parashikimet/planifikimin e nevojave të tregut vendas për furnizimet e nevojshme me naftë bruto;*
 - ii. *Të mbikëqyrë planet e furnizimit të tregut vendas nga ana e Bankers Petroleum Albania LTD.*
 - VI. *T’i rekomandojë AKBN, në respektim të Marrëveshjes Hidrokarbure:*
 - i. *Në bashkëpunim me Albpetrol, të bëjë parashikimet/planifikimin e nevojave të tregut vendas për furnizimet e nevojshme me naftë bruto;*
 - ii. *Të mbikëqyrë dhe monitorojë planet e prodhimit të naftës bruto nga ana e Bankers Petroleum Albania LTD.*
 - VII. *Moszbatimi i përmbushjes së pikës II, III dhe IV të këtij vendimi, në zbatim të nenit 73 dhe 74 të ligjit 9121/2003 ndërshkohet me penaltitetet përkatëse.*
 - VIII. *Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD për një periudhë 1 (një) vjeçare, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Gjatë periudhës së monitorimit, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD duhet të raportojë çdo 3 (tre) muaj pranë AK të dhëna lidhur me ecurinë e zbatimit të pikave II, III dhe IV të këtij vendimi.*

2. Nëpërmjet pikës VIII të Vendimit nr. 702/2020 të Komisionit të Konkurrencës është vendosur monitorimi i sjelljes së ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD për një periudhë 1 (një) vjeçare, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, si dhe detyrimi i kësaj ndërmarrje për të raportuar çdo 3 (tre) muaj pranë Autoritetit të Konkurrencës të dhëna lidhur me ecurinë e zbatimit të pikave II, III dhe IV të këtij vendimi.
3. Me qëllim realizimin e procedurave të monitorimit në zbatim të pikave II, III dhe IV të VKK nr. 702/2020, bazuar në nenet 33 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nga Autoriteti i Konkurrencës (AK) është kërkuar informacion nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD, nëpërmjet shkresave nr. 307/5 prot. datë 12.11.2020; nr. 307/10 prot, datë 07.12.2020; si dhe nr. 168 prot, datë 26.03.2021, në përgjigje të të cilave, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD, ka depozituar informacion me anë të shkresave: nr. 729/3 prot, datë 20.11.2020 (Prot. AK nr. 307/8, datë 24.11.2020); nr. 729/5 prot, datë 29.12.2020 (Prot. AK nr. 307/13, datë 05.01.2021); nr. 119 prot., datë 29.01.2021 (Prot. AK nr. 307/14, datë 03.02.2021); si dhe nr. 306/1 prot, datë 8.04.2021 (Prot. AK nr. 168/1, datë 08.04.2021).
4. Nga vlerësimi i informacionit të depozituar nëpërmjet shkresave të mësipërme, në zbatim të VKK nr. 702/2020, ka rezultuar se ky informacion nuk përmbush detyrimet e dhëna Bankers Petroleum Albania LTD sipas pikës III të VKK nr. 702/2020, pasi nuk ka sjellë të dhënat e kërkuara sipas kësaj pike. Konkretisht Bankers Petroleum Albania LTD nuk ka zbatuar pikën III të VKK nr. 702/2020 në lidhje me kostot e naftës, prodhimin e naftës dhe operacionet hidrokarbure, sjellje kjo e cila në kuptim të nenit 74, pika c), të ligjit nr. 9121/2003 gjohet në deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës.
5. Në respektim të pikës IV të VKK nr. 702/2020, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ka depozituar pranë AK draft-kontratën e shitjes së naftës bruto, për periudhën 29 janar 2021 - 31 dhjetor 2021, ndërmjet Bankers Petroleum Albania LTD dhe rafinerinë vendase AL. Global Oil SHA. Pas vlerësimit paraprak të draft-kontratës, nëpërmjet shkresës nr. 168 prot, datë 26.03.2021, ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD i është kërkuar bërja e ndryshimeve përkatëse referuar pikave 3.2 dhe 3.3 të nenit 3, si dhe pikës 6.1 të nenit 6 të draf-kontratës, me qëllim vendosjen e Blerësit Al. Global Oil SHA përballë kushteve të drejta të tregtimit.
6. Në përgjigje të këtyre kërkesave, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ka bërë amendimin nr. 1 të kontratës fillestare duke ndryshuar nenet 3 dhe 6 të kontratës fillestare. Konkretisht pika 3.2 është riformuluar duke u hequr e drejta e Bankers për të zgjedhur nëse do të dorëzojë vëllimet e naftës bruto të kërkuara nga blerësi Al. Global Oil SHA, si dhe përcaktohet më qartë procedura e negocimit, nëpërmjet takimeve dhe/ose komunikimeve elektronike, midis palëve mbi hartimin e Programit Mjor të Dorëzimit të naftës bruto, duke reflektuar ndryshimet e propozuara nga AK.

Nga ana tjetër, në kundërshtim me nenin 33/1 të ligjit nr. 9121/2003, ku sanksionohet se “Në çdo kohë, Autoriteti, me anë të një kërkesë të sekretariatit ose të komisionit, mund t’u kërkojë të tretëve, ndërmarrjeve ose grupimeve të ndërmarrjeve, t’i sigurojnë të gjitha informacionet e nevojshme, për zbatimin e këtij ligji, përfshirë edhe ato, të cilat përmbajnë sekrete tregtare” dhe në shpërfillje të detyrimeve që neni 30 vendos mbi AK lidhur me të dhënat konfidenciale që merren nga ndërmarrjet, Bankers Petroleum Albania LTD na njofton se: “Për shkak të detyrimeve kontraktore për konfidencialitetin e këtyre elementëve të marrëdhënies kontraktore e kemi objektivisht të pamundur t’ju vëmë në dispozicion në mbështetje të kësaj komunikimit me email që do të konfirmonin këtë deklaram tonin”.

7. Sa i përket amendimit të nenit 6.1, ai është riformuluar duke përcaktuar sasinë e furnizimit me naftë bruto të rafinerisë Al Global Oil SHA edhe për muajt prill, maj e qershor 2021, ndërsa për muajt korrik-dhjetor 2021, përcaktohet se *palët në baza tre mujore do të bien dakord bashkërisht për sasinë e naftës bruto që do të dorëzohet çdo muaj sipas parashikimeve të prodhimit të shitësit/Bankers dhe furnizimin me prodhim të nevojitur nga blerësi/Al.Global.*
8. Sa më sipër rezulton se Bankers Petroleum Albania LTD në amendimimin e bërë draft-kontratës së shitjes së naftës bruto me rafinerinë vendase AL. Global Oil SHA, për periudhën 29 janar 2021 - 31 dhjetor 2021, nuk ka zbatuar kërkesat e AK sipas shkresës nr. 168 prot, datë 26.03.2021, mbi përcaktimin e sasisë së furnizimit të naftës bruto për gjithë muajt e vitit 2021, bazuar në nevojat normale të rafinerisë Al Global Oil SHA, me qëllim vendosjen e Blerësit Al. Global Oil përballë kushteve të drejta të tregtimit, në përmbushje të detyrimeve të lëna sipas pikës II të VKK nr. 702/2020.
9. Bazuar sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 793, datë 22.04.2021 “Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 702, datë 30.07.2020, nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD”, ka vendosur:
 - I. *Detyrimin e Bankers Petroleum Albania LTD, si ndërmarrje me pozitë dominuese në tregun e prodhimit të naftës bruto, të zbatojë detyrimet e dhëna me VKK nr. 702/2020.*
 - II. *Detyrimin e ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD si ndërmarrje me pozitë dominuese në tregun e prodhimit të naftës bruto në RSH:*
 - *Të aplikojë kushte tregtimi të barabarta për veprime tregtare të njëjta ndaj ndërmarrjeve me të cilat hyn në marrëdhënie kontraktore;*
 - *Të furnizojë ndërmarrjet e përpunimit të naftës bruto në tregun vendas, në respektim të marrëdhënieve kontraktore bazuar në dispozitat e Kodit Civil.*
 - III. *Detyrimin e Bankers Petroleum Albania LTD të depozitojë pranë AK:*
 - *çdo raportim tremujor mbi kostot e naftës;*
 - *çdo raportim tremujor mbi prodhimin e naftës dhe operacionet hidrokarbure.*
 - IV. *Në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 702/2020, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe dhënien e disa detyrimeve dhe rekomandimeve për ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania*

LTD, Albpetrol dhe AKBN”, periudha e monitorimit e përcaktuar në pikën VIII, shtyhet deri në 31 korrik të vitit 2022.

- V. *Në rast të mos përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në këtë vendim, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika I, gërma (c) të ligjit nr. 9121/2003.*
- VI. *Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.*
10. Në zbatim të VKK nr. 702/2020, si dhe VKK nr. 793/2021 Autoriteti Konkurrencës ka vazhduar monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD për periudhën në vijim deri në 31 korrik të vitit 2022.
11. Në respektim të pikës III të VKK nr. 702/2020 dhe VKK nr. 793/2021, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ka detyrimin të depozitojë pranë AK-së çdo raportim tremujor mbi kostot e naftës, çdo raportim tremujor mbi prodhimin e naftës dhe operacionet hidrokarbure.
12. Në përmbushje të zbatimit të këtyre detyrimeve, në vijim të monitorimit ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ka depozituar këto shkresa:
- me shkresën nr. 409 prot, datë 30.04.2021 (protokolluar me tonën nr. 163/4 prot, datë 04.05.2021), Bankers Petroleum Albania LTD ka depozituar për pranë AK-së të dhëna lidhur me sasinë e prodhuar, koston e prodhimit dhe çmimin e shitjes së naftës bruto, për periudhën Janar – Mars 2021;
 - me shkresën nr. 678 prot, datë 02.08.2021 (protokolluar me tonën nr. 168/9 prot, datë 09.08.2021), ka depozituar pranë AK-së raportimin tre mujor të kostove dhe volumeve të prodhimit të naftës bruto për periudhën Prill – Qershor 2021;
 - me shkresën nr. 090 prot, datë 31.01.2022 (protokolluar me tonën nr. 78 prot, datë 01.02.2022), ka depozituar për pranë AK-së të dhëna lidhur me sasinë e prodhuar, koston e prodhimit dhe çmimin e shitjes së naftës bruto, për periudhën Tetor – Dhjetor 2021;
 - me shkresën nr. 382 prot, datë 28.04.2022 (protokolluar me tonën nr. 78/1 prot, datë 04.05.2022), ka depozituar pranë AK-së raportimin tre mujor të kostove dhe volumeve të prodhimit të naftës bruto për periudhën Janar – Mars 2022;
 - me shkresën nr. 615/1 prot, datë 29.07.2022 (protokolluar me tonën nr. 78/9 prot, datë 01.08.2022), ka depozituar pranë AK-së raportimin tre mujor të kostove dhe volumeve të prodhimit të naftës bruto për periudhën Prill – Qershor 2022 dhe Korrik – Shtator 2021.
13. Nga të dhënat e depozituara vihet re se prodhimi i naftës bruto ka rënë gjatë periudhës së monitorimit nga korriku 2020 në qershor 2022, ndërsa kosto e prodhimit dhe çmimi i shitjes së naftës bruto janë rritur, si dhe dallohet trendi që kanë ndjekur kosto e prodhimit dhe çmimi i shitjes së naftës bruto dhe se diferenca midis tyre ka ardhur duke u rritur. Edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2022, periudhë në të cilën kosto e prodhimit ka pësuar rënie, çmimi i shitjes së naftës bruto ka vijuar të rritet.

14. Nga vlerësimi i informacionit të depozituar nëpërmjet shkresave të mësipërme, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve në zbatim të VKK nr. 702/2020 dhe VKK nr. 793/2021, rezulton se në përfundim të periudhës së monitorimit, 31 korrik 2022, informacioni i sjellë nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD nuk është i plotë për sa i përket pikës III të VKK nr. 702/2020 dhe VKK 793/2021, pasi nuk ka raportuar të dhënat e kërkuara sipas kësaj pike lidhur me kostot e naftës dhe prodhimin e naftës për muajin korrik të vitit 2022, si dhe në lidhje me operacionet hidrokarbure¹ gjatë vitit 2021 dhe periudhës janar – korrik 2022.
15. Theksojmë faktin se ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ka depozituar informacion për zbatimin e vendimeve të Komisionit të Konkurrencës nr. 702/2020 dhe nr. 793/2021 vetëm me kërkesë të AK, duke e vendosur vazhdimisht AK në një pozitë të vështirë për të realizuar detyrat dhe funksionet e veta të parashikuara nga ligji.
16. Sa më sipër, Autoriteti i Konkurrencës me anë të shkresës nr. 78/10 prot., datë 07.09.2022 “Kërkesë për zbatimin e Vendimeve të Komisionit të Konkurrencës nr. 702/2020 dhe 793/2021”, i ka bërë me dije ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD se në përfundim të periudhës së monitorimit rezulton se ndërmarrja nuk ka përmbushur kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në pikat II, III dhe IV të VKK nr. 702/2020 dhe VKK nr. 793/2021 dhe mos përmbushja e kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në pikat II, III dhe IV të VKK nr. 702/2020 dhe VKK nr. 793/2021, nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ndëshkohet me gjobë deri në 10% të xhiros vjetore të vitit paraardhës për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa (c) të ligjit nr. 9121/2003.
17. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj shkrese, ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD i është kërkuar informacion mbi zbatimin e pikave II, III dhe IV të VKK nr. 702, datë 30.07.2020 dhe VKK nr. 793, datë 22.04.2021 për muajin korrik 2022.
18. Në zbatim të ligjit nr. 7746/1993 “Për Hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)” ndërmarrja Albpetrol SHA është autorizuar nga Ministria përkatëse, përfaqësuar nga AKBN, nëpërmjet “Licencë Marrëveshjes” së datës 7 qershor 2004, për të kërkuar, zhvilluar e prodhuar hidrokarbure në zonën e kontratës. Sipas pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 7746/1993, Ministria përkatëse lidh marrëveshje hidrokarbure apo autorizon Albpetrolin, nëpërmjet një licence për lidhjen e një marrëveshjeje hidrokarbure, me një person, në qoftë se vlerëson se personi ka burimet financiare dhe kompetencën teknike të kërkuar për të përmbushur detyrimet e kontraktorit nën marrëveshjen

¹ “Operacione hidrokarbure” janë të gjitha ose çdo operacion që lidhet me kërkimin, vlerësimin e një zbulimi, zhvillimin, nxjerrjen, prodhimin, ndarjen e trajtimin, grumbullimin, transportimin dhe shitjen ose disponimin e hidrokarbureve deri në pikën e eksportit ose në një pikë livrimi në Shqipëri, për të cilën është rënë dakord, ose në pikën e hyrjes në një rafineri dhe përfshin operacionet e përpunimit të gazit natyror, por nuk përfshin operacionet e përpunimit të hidrokarbureve. (neni 2 i ligjit 7746/1993 “Për hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)”).

hidrokarbure. Albpetrol SHA ka lidhur MH për vendburimin e Patos-Marinzës me ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD (ish Saxon International Energy LTD), marrëveshje kjo e miratuar me VKM nr. 477, datë 16.07.2004 “Për Miratimin e Marrëveshjes për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e Patos-Marinzës”, të ndryshuar. Zbatimi i Marrëveshjeve Hidrokarbure si dhe mbikëqyrja e veprimtarive hidrokarbure ndiqet nga Albpetrol dhe AKBN si përfaqësuese e Ministrisë përkatëse.

19. Për të realizuar procedurën e monitorimit të zbatimit të VKK. nr. 702, datë 30.07.2020 dhe VKK nr. 793, datë 22.04.2021, Autoriteti i Konkurrencës, i gjendur përpara vështirësive të shpjeguara më lart, ka kërkuar informacion nga rregullatori i tregut AKBN dhe nga Albpetrol SHA, e cila është ndërmarrja që ka nënkontraktuar shoqërinë Bankers Petroleum Albania LTD në zbatim të ligjit nr. 7746/1993 “Për Hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)” dhe VKM nr. 477, datë 16.07.2004 “Për Miratimin e Marrëveshjes për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e Patos-Marinzës”, të ndryshuar.
20. Gjatë procedurës së monitorimit nga Albpetrol dhe AKBN është kërkuar informacion në lidhje me masat e marra në zbatim të VKK nr. 702/2020 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe dhënien e disa detyrimeve dhe rekomandimeve për ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD, Albpetrol dhe AKBN” dhe VKK nr. 793/2021, me anë të shkresave, si më poshtë vijon:
 - Shkresa nr. 307/6 prot., datë 12.11.2020, drejtuar AKBN;
 - Shkresa nr. 307/7 prot., datë 12.11.2020, drejtuar Albpetrol SHA;
 - Shkresa nr. 168/6 prot., datë 01.07.2021, drejtuar AKBN;
 - Shkresa nr. 168/7 prot., datë 01.07.2021, drejtuar Albpetrol SHA;
 - Shkresa nr. 78/2 prot., datë 01.06.2022, drejtuar Albpetrol SHA dhe AKBN.
21. Gjatë kësaj procedure për zbatimin e VKK nr. 702/2020 dhe VKK nr. 793/2021, Albpetrol SHA dhe AKBN nuk i janë përgjigjur kërkesave tona për informacion.
22. Megjithatë, me anë të shkresës nr. 78/11 prot., datë 07.09.2022 “Kërkesë për informacion”, drejtuar shoqërisë Albpetrol SHA, si shoqëri e autorizuar për lidhjen e Marrëveshjes Hidrokarbure me kontraktorin Bankers Petroleum Albania LTD, përsëri është kërkuar informacion mbi pikat III dhe IV të VKK nr. 702, datë 30.07.2020 dhe VKK nr. 793, datë 22.04.2021, lidhur me:
 - raportimet tremujore mbi kostot e naftës nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD, për periudhën 1 korrik 2020 – 31 korrik 2022;
 - raportimet tremujore mbi prodhimin e naftës dhe operacionet hidrokarbure nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD, për periudhën 1 korrik 2020 – 31 korrik 2022;
 - çdo draft kontratë të lidhur nga ndërmarrja Bankers Petroleum albania LTD me çdo rafineri për periudhën 1 korrik 2020 – 31 korrik 2022.

23. Me anë të shkresës nr. 78/12 prot., datë 19.09.2022, Albpetrol SHA në kuadër të përmbushjes së dy pikave të para të kërkesës sonë për informacion, lidhur me raportimet tremujore mbi kostot e naftës, raportimet tremujore mbi prodhimin e naftës dhe operacionet hidrokarbure ka sjellë Progres Raportet tremujore të depozituara nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD pranë Albpetrol, nga tremujori i tretë 2020 deri në tremujorin e parë 2022 (1 korrik 2020 – 31 mars 2022). Për sa i përket të dhënave për tremujorin e dytë 2020, në shkresën e tij, Albpetrol shprehet se ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD nuk e ka dërguar akoma Progres Raportin për këtë tremujor.
24. Në përgjigje të shkresës sonë nr. 78/11 prot., datë 07.09.2022, pas përfundimit të procedurës së monitorimit të zbatimit të VKK nr. 702/2020 dhe VKK nr. 793/2021, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD, me shkresën nr. 615/3 prot, datë 20.09.2022 (protokolluar me tonën nr. 78/14 prot, datë 21.09.2022), ka depozituar pranë AK raportimin e kostove dhe volumeve të prodhimit të naftës bruto për muajin Korrik 2022, por nuk ka depozituar operacionet hidrokarbure, duke mospërmbushur kushtet dhe detyrimet e dhëna me VKK nr. 702/2020 dhe VKK nr. 793/2021.
25. Nga vlerësimi i informacionit të depozituar nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD, në zbatim të VKK nr. 702/2020 dhe VKK nr. 793/2021, rezulton se ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD nuk ka përmbushur detyrimet e dhëna sipas pikës III të VKK nr. 702/2020. Konkretisht Bankers Petroleum Albania LTD nuk ka zbatuar pikën III të VKK nr. 702/2020 dhe VKK nr. 793/2021 në lidhje me operacionet hidrokarbure gjatë vitit 2021 dhe periudhës janar – korrik 2022, si dhe në lidhje me kostot e naftës dhe prodhimin e naftës për muajin korrik të vitit 2022, pasi të dhënat janë depozituar pas përfundimit të procedurës së monitorimit, sjellje kjo e cila në kuptim të nenit 74, pika c), të ligjit nr. 9121/2003 gjobitet në deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës.
26. ***Nëpërmjet pikës II të VKK nr. 702/2020 dhe VKK nr. 793/2021 ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD i është dhënë detyrimi që:***
- 1. Të aplikojë kushte tregtimi të barabarta për veprime tregtare të njëjta ndaj ndërmarrjeve me të cilat hyn në marrëdhënie kontraktore;*
 - 2. Të furnizojë ndërmarrjet e përpunimit të naftës bruto në tregun vendas, në respektim të marrëdhënieve kontraktore bazuar në dispozitat e Kodit Civil.*
27. ***Zbatimi i këtij detyrimi është i lidhur me zbatimin e pikës IV të VKK nr. 702/2020,*** në respektim të së cilës ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ka detyrimin të depozitojë pranë AK-së për vlerësim paraprak çdo draft kontratë që do të lidhë me çdo rafineri, në respektim të detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
28. Në zbatimin e pikës IV të VKK nr. 702/2020, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD, me shkresën nr. 678 prot, datë 02.08.2021 (protokolluar me tonën nr. 168/9 prot, datë 9.8.2021), ka depozituar për vlerësim paraprak pranë AK-së draft-kontratën

e shitjes së naftës bruto me rafinerinë vendase R.B.H. Beline SHA, për periudhën gusht-dhjetor 2021. Pas vlerësimit paraprak të kësaj draft-kontrate, me shkresën nr. 168/10 prot, datë 14.09.2021, AK ka kërkuar nga Bankers Petroleum Albania LTD që:

- a) Në draft kontratën e furnizimit me naftë bruto të R.B.H. Beline SHA të reflektojë ndryshimet e propozuara nga AK me shkresën nr. 168 prot, datë 26.03.2021, me qëllim vendosjen e kushteve të barabarta për veprime tregtare të njëjta me palët. Konkretisht nga AK është kërkuar “riformulimi i pikave 3.2 dhe 3.3 të kësaj kontrate, duke evidentuar qartë detyrimin e Bankers Petroleum Albania LTD për të furnizuar blerësin/ R.B.H. Beline SHA me vëllimet mujore të naftës bruto, si dhe të përcaktojë qartë procedurat e negocimit, nëpërmjet takimeve dhe/ose komunikimeve elektronike, midis palëve mbi hartimin e Planifikimit Mujor të Dorëzimit të naftës bruto.
29. Ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD me shkresën nr. 595 prot, datë 01.08.2021 (protokolluar me tonën nr. 168/8 prot, datë 05.07.2021) Bankers ka depozituar Amendimin nr.2 të kontratës së shitjes së naftës bruto me rafinerinë vendase AL. Global Oil SHA. Pas vlerësimit paraprak të këtij Amendimi, me shkresën tonë nr. 168/10 prot, datë 14.09.2021, AK ka kërkuar nga Bankers Petroleum Albania LTD që të përcaktojë sasinë e furnizimit të naftës bruto për gjithë muajt e vitit 2021, bazuar në nevojat normale të rafinerisë Al.Global Oil SHA.
 30. Në përgjigje të kërkesave të mësipërme të AK-së, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD me shkresën nr. 780/1 prot., datë 23 shtator 2021(Prot. AK nr. 168/11, dt. 27.09.2021) ka depozituar pranë AK-së draft-shtesat e kontratave të shitjes së naftës bruto me R.B.H Beline SHA dhe AL-Global SHA, në gjuhën angleze, e cila nuk është gjuhë zyrtare në Republikën e Shqipërisë dhe, vetëm pas insistimit tonë, në përgjigje të kërkesës sonë nr. 168/13 prot, datë 22.10.2021, Bankers Petroleum LTD me shkresën nr. 780/3 prot, datë 11.11.2021 (protokolluar me tonën nr. 168/15 prot, datë 12.11.2021), ka depozituar pranë AK draft-shtesë kontratat e shitjes së naftës bruto me R.B.H Beline SHA dhe AL-Global SHA në gjuhën shqipe.
 31. Nga vlerësimi i këtyre dy draft-shtesë kontratave të shitjes së naftës bruto rezulton si vijon:
 1. *Draft-shtesë kontrata e shitjes së naftës bruto, propozuar nga Bankers Petroleum Albania LTD për shitjen e volumeve të naftës bruto tek R.B.H Beline SHA (viti 2021).*
 32. Në amendimin/draft-shtesë kontratën e shitjes së naftës bruto ndërmjet Bankers Petroleum Albania LTD dhe R.B.H. Beline SHA, që mban datën 21 shtator 2021, janë bërë ndryshimet e neneve/pikave 3.2 dhe 3.3 të draft kontratës fillestare.
 33. Bankers Petroleum Albania LTD ka reflektuar ndryshimet e propozuara nga AK duke i dhënë rafinerisë R.B.H. Beline SHA mundësi negocimi mbi hartimin e Programit Mujor të Dorëzimit të naftës bruto, duke hequr të drejtën e Bankers Petroleum Albania LTD për të zgjedhur nëse do të dorëzojë vëllimet e naftës bruto të kërkuara nga blerësi

R.B.H. Beline SHA, duke evidentuar më qartë detyrimin e Bankers Petroleum Albania LTD për të furnizuar blerësin/ R.B.H. Beline SHA, si dhe duke përcaktuar më qartë procedurat e negocimit, nëpërmjet takimeve dhe/ose komunikimeve elektronike, midis palëve.

2. *Draft-shtesë kontrata e shitjes së naftës bruto, propozuara nga Bankers Petroleum Albania LTD për shitjen e volumeve të naftës bruto tek "AL-Global" SHA (viti 2021).*
34. Në Amendimin nr. 3 të kontratës së shitjes së naftës bruto ndërmjet Bankers Petroleum Albania LTD dhe rafinerisë vendase AL. Global Oil SHA, është bërë ndryshimi i nenit 6.1 i kontratës fillestare, duke përcaktuar sasinë e furnizimit me naftë bruto të rafinerisë Al.Global Oil SHA edhe për muajt tetor-dhjetor 2021, duke zbatuar në këtë mënyrë kërkesat e AK mbi përcaktimin e sasisë së furnizimit të naftës bruto për gjithë muajt e vitit 2021, bazuar në nevojat normale të rafinerisë Al.Global Oil SHA.
35. Sa më sipër rezulton se Bankers Petroleum Albania LTD nëpërmjet amendimit nr. 3 të kontratës së shitjes së naftës bruto ndërmjet Bankers Petroleum Albania LTD dhe rafinerisë vendase AL. Global Oil SHA ka zbatuar kërkesat e AK mbi përcaktimin e sasisë së furnizimit të naftës bruto për gjithë muajt e vitit 2021, por informacioni përfundimtar nga Bankers Petroleum Albania LTD është sjellë pranë AK vetëm pas kërkesës së AK, duke mos zbatuar detyrimin e pikës II të VKK nr. 793/2021.

Vlerësimi i kontratave të depozituara nga Bankers Petroleum Albania LTD për vitin 2022:

1. *Draft - Kontrata e shitjes së naftës së papërpunuar/bruto Patos-Marinza, ndërmjet "AL-Global" SHA dhe Bankers Petroleum Albania LTD, për vitin 2022.*
36. Bankers Petroleum Albania LTD, me anë të shkresës së saj nr. 382 prot., datë 28.04.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 78/1 prot., datë 04.05.2022) dhe nr. 575 prot., datë 04.07.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 78/3 prot., datë 07.07.2022) ka depozituar për vlerësim paraprak pranë AK-së draft-kontratën e shitjes së naftës bruto me rafinerinë vendase AL. Global Oil SHA, për periudhën 1 maj 2022 - 31 dhjetor 2022, si dhe draft shtesë kontratën përkatëse. Nga vlerësimi paraprak i kësaj draft kontrate rezultoi se, ajo *ka reflektuar pjesërisht* ndryshimet e propozuara nga AK me shkresën nr. 168 prot, datë 26.03.2021, sa i përket pikës 3.2 të nenit 3 të draft-kontratës. Gjithashtu ky nen nuk është hartuar në përputhje me Amendimin nr. 1 të kontratës fillestare (viti 2021), depozituar pranë AK nëpërmjet shkresës së ndërmarrjes Bankers me nr. 306/1 prot, datë 8.04.2021.
37. Sa i përket nenit 6 të kontratës, në pikën 6.1, të ndryshuar, përcaktohet sasia mujore e furnizimit me naftës bruto të rafinerisë Al.Global Oil SHA për muajt Maj – Gusht 2022, ndërsa për periudhën Shtator-Dhjetor 2022, përcaktohet se palët në baza tremujore ose mujore do të bien dakord reciprokisht për sasinë e naftës bruto që do të

dorëzohet çdo muaj sipas parashikimit të prodhimit të Shitësit/Bankers dhe gjithashtu furnizimit të nevojshëm për prodhim nga Blerësi/Al. Global Oil SHA.

38. Lidhur me këtë nen, sa i përket kontratës së vitit 2021 me rafinerinë Al.Global Oil SHA, me shkresën tonë nr. 168/10 prot, datë 14.09.2021, ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD i është kërkuar të zbatojë kërkesat e AK mbi përcaktimin e sasisë së furnizimit të naftës bruto për gjithë muajt e vitit 2021, bazuar në nevojat normale të rafinerisë Al.Global Oil SHA. Gjithashtu, referuar kontratës së shitjes së naftës bruto të lidhur nga ndërmarrja Bankers me rafinerisë vendase R.B.H Beline SHA, gjatë vitit 2021, ka rezultuar se Bankers për periudhën e kontratës ka përcaktuar sasinë e shitjes së naftës bruto për çdo muaj ndaj rafinerisë vendase R.B.H. Beline SHA.
39. Sa më sipër, në përmbushje të detyrimit të ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD që të aplikojë kushte tregtimi të barabarta për veprime tregtare të njëjta ndaj ndërmarrjeve me të cilat hyn në marrëdhënie kontraktore, me anë të shkresës sonë nr. 78/5 prot, datë 19.07.2022, është kërkuar nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD që të reflektojë në kontratën e furnizimit me naftë bruto të Al.Global Oil SHA, për vitin 2022, ndryshimet e propozuara me shkresën tonë nr. 168 prot, datë 26.03.2021, si në Amendimin nr. 1 të kontratës fillestare (viti 2021), depozituar pranë AK nëpërmjet shkresës së ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD me nr. 306/1 prot, datë 8.04.2021, si dhe në këtë kontratë të përcaktohet sasia e furnizimit të naftës bruto edhe për muajt Shtator-Dhjetor 2022, bazuar në nevojat normale të rafinerisë Al.Global Oil SHA.
40. Në përgjigje të kërkesave të mësipërme të AK-së, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD nëpërmjet shkresës së saj nr. 575/2 prot., datë 29.07.2022 (Protokolluar pranë AK me nr. 78/8 prot, datë 01.08.2022), ka dhënë sqarimet dhe shpjegimet e saj duke mos reflektuar ndryshimet e propozuara nga AK në mënyrë të përsëritur.
41. Sa më sipër ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD, si një ndërmarrje me pozitë dominuese në tregun e prodhimit të naftës bruto në RSH, nuk ka zbatuar detyrimin e pikës II të VKK nr. 793/2021 duke mos aplikuar kushte tregtimi të barabarta për veprime tregtare të njëjta ndaj ndërmarrjeve me të cilat hyn në marrëdhënie kontraktore, edhe pas vlerësimeve dhe rekomandimeve të dhëna në vazhdimësi nga AK.
42. Referuar pikës II/2 të VKK nr. 702/2020, ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD si një ndërmarrje me pozitë dominuese në tregun e prodhimit të naftës bruto në RSH, i është rekomanduar që: *“Të furnizojë ndërmarrjet e përpunimit të naftës bruto në tregun vendas, në respektim të marrëdhënieve kontraktore bazuar në dispozitat e Kodit Civil”*.
43. Për vetë natyrën periodike dhe të vazhdueshme të kontratës së furnizimit me naftë bruto, në përmbushje të detyrimeve që ka Bankers Petroleum Albania LTD si palë

furnizuese me pozitë dominuese në tregun e prodhimit të naftës bruto, nevojitet që në kontratën përkatëse të përcaktohet sasia e furnizimit të naftës bruto për muaj, bazuar në nevojat normale të rafinerisë Al.Global Oil SHA, si dhe të bëjë ndryshimet përkatëse në kontratë me qëllim vendosjen e Blerësit Al. Global Oil përballë kushteve të drejta të tregtimit.

44. Si përfundim rezulton se, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD, një ndërmarrje me pozitë dominuese në tregun e prodhimit të naftës bruto në RSH, nuk ka zbatuar me vullnet të lirë detyrimin sipas pikave II dhe IV të VKK. nr. 702, datë 30.07.2020 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe dhënien e disa detyrimeve dhe rekomandimeve për ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD, Albpetrol dhe AKBN” dhe VKK nr. 793, datë 22.04.2021, “Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 702, datë 30.07.2020, nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD”, për të aplikuar kushte tregtimi të barabarta për veprime tregtare të njëjta ndaj ndërmarrjeve me të cilat hyn në marrëdhënie kontraktore. Sjellim në vëmendje se zbatimi i vendimeve VKK nr.702/2020 dhe VKK 793/2021 janë vendime përfundimtare e të detyrueshme për zbatim për shoqërinë Bankers Petroleum Albania LTD.
45. Ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD nuk ka përmbushur detyrimet e dhëna sipas pikës III të VKK nr. 702/2020 dhe VKK nr. 793/2021 në lidhje me operacionet hidrokarbure gjatë vitit 2021 dhe periudhës janar – korrik 2022, si dhe në lidhje me kostot e naftës dhe prodhimin e naftës për muajin korrik të vitit 2022, pasi të dhënat janë depozituar pas përfundimit të procedurës së monitorimit, sjellje kjo ndëshkueshme në kuptim të nenit 74, pika c), të ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 26, 45, neni 74, pika 1, gërma (c), të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Konstatimin e mos-zbatimit të Vendimeve të Komisionit të Konkurrencës nr. 702, datë 30.07.2020 dhe nr. 793, datë 22.04.2021, nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD.
- II. Gjykitjen e ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD për mos-zbatim të Vendimeve të Komisionit të Konkurrencës nr. 702, datë 30.07.2020 dhe nr. 793, datë 22.04.2021, nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD në vlerën 19, 863,145 (nëntëmbëdhjetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e njëqind e dyzet e pesë) Lekë.

III. Mbylljen e procedurës së monitorimit në zbatim të VKK nr. 702, datë 30.07.2020, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe dhënien e disa detyrimeve dhe rekomandimeve për ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD, Albpetrol dhe AKBN”, dhe VKK nr. 793, datë 22.04.2021 “Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 702, datë 30.07.2020, nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD”.

IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA


Zv/Kryetar

Rezana KONOMI


Anëtar

Adriana BERBERI


Anëtar

Durim KRAJA


Anëtar

Denar BIBA

